VENDIM
Nr. 437, datë 15.7.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 544, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK '*GREEN COAST*'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 544, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 2, fjalët "... 20 (njëzet) vjet ..." zëvendësohen me "... 30 (tridhjetë) vjet ...".

2. Në pikën 2.1, fjalët "... brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar me vendim KIS-it." zëvendësohen me "... brenda koordinatave të sipërfaqes, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi. Pagesa kryhet çdo vit, bazuar në sipërfaqen, objekt përdorimi.".

3. Pas pikës 2.1 shtohet pika 2.1.1, me këtë përmbajtje:

"2.1.1 Përjashtimisht, kontrata mund të rishikohet me kërkesë të investitorit strategjik "*Green Coast*", në rast se kërkohen të shtohen sipërfaqe plazhi në përdorim, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.".

4. Në pikën 3, fjalët "15 maj – 30 shtator të çdo viti" zëvendësohen me "… të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për turizmin".

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË NR. 1
KOORDINATAT PËR PROJEKTIN KOORDINATAT PËR PROJEKTIN
"GREEN COAST 1 GREEN COAST 2"

Nr.	**E**	**N**
1	464264.309	4448729.419
2	464273.238	4448740.565
3	464293.740	4448725.18
4	464320.479	4448742.914
5	464342.367	4448736.317
6	464344.958	4448723.376
7	464356.809	4448723.360
8	464429.569	4448713.179
9	464453.808	4448682.839
10	464449.109	4448657.603
11	464513.437	4448579.577
12	464534.755	4448560.219
13	464590.104	4448522.941
14	464627.341	4448497.138
15	464636.507	4448479.854
16	464646.193	4448474.645
17	464692.341	4448435.202
18	464697.368	4448428.244
19	464709.890	4448424.637
20	464721.706	4448413.034
21	464736.913	4448375.511
22	464744.122	4448372.083
23	464762.315	4448372.932
24	464796.437	4448348.883
25	464777.917	4448313.233
26	464796.147	4448292.185
27	464779.905	4448276.481
28	464794.727	4448236.971
29	464816.744	4448227.085
30	464801.916	4448216.141
31	464744.679	4448150.808
32	464584.515	4448363.303
33	464422.357	4448561.558
34	464320.335	4448678.780

Nr.	**E**	**N**
1	464798.401	4448211.494
2	464949.135	4448006.771
3	464901.215	4447975.274
4	464744.679	4448150.807